

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 7058  
E hënë, 27 nëntor 2023  
Çmimi 0.50

## Dhjetëra pengje izraelite dhe të huaj të liruar gjatë tri ditëve armëpushim

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# NË PODUJEVË INAUGUROHET SHTATORJA E IKONËS KOMBËTARE ADEM DEMAÇI

FAQE 3



Në Podujevë të dielën është bërë zbulimi i shtatores së veprimtarit të çështjes kombëtare Adem Demaçi. Në këtë ngjarje të pranishëm ishin edhe kryeministri i Kosovës, Albin

Kurti, kryetari i Podujevës, Shpejtim Bulliçi, ish-presidenti Fatmir Sejdiu, deputetë, veprimtarë të çështjes kombëtare, si dhe familja e Demaçit. Në zbulimin e shtatores u tha se

Demaçi ishte personalitet unik, i cili punoi deri në frymën e fundit për lirinë dhe pavarësinë e popullit të tij duke sakrifikuar jetën në shërbim të kauzës jetësore për liri

## OPINION

### FONDI SOVRAN DËMTON KONKURENCËN, INVESTIMET PRIVATE, NDËRMARRJET PUBLIKE DHE BUXHETIN E SHTETIT F.7

Shkruan:  
Avdullah HOTI



## AKTUALE



### KRASNIQI: NË RAPORTIN E PROGRESIT ËSHTË PËRMENDUR 99 HERË FJALA KORRUPSION F.5

### VOTIMI I MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE, AJO ME DANIMARKËN VLERËSOHET SI PROBLEMATIKE NË PËRMBAJTJE F.5

### POLICIA PO I HETON DYSHIMET PËR SHPËRTHIMIN E NJË GRANATE NË VERI F.6


## EKONOMI



### PRODHIMI I ENERGJISË BIE, KONSUMI RRIET F.8

## SAGA PA FUND E SIGURIMEVE SHËNDETËSORE NË KOSOVË

FAQE 4



### ASOCIACIONI SIPAS KËTIJ DRAFTI E STIMULON EDHE MË SHUMË KONFLIKTIN E ARMATOSUR

Milazim KRASNIQI

FAQE 6



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Fax: +389 44 487 200  
Mbx: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Netanyahu viziton trupat izraelite në Gaza: Të vazhdojmë deri në fitore

Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu ka vizituar trupat në Gaza për të biseduar nga afër me ushtarët dhe komandantët në terren gjatë konfliktit. Netanyahu tha se po bëhej "çdo përpjekje" për t'i rikthyer pengjet e mbetura

dhe "në fund do t'i kthejmë të gjithë". "Ne kemi tre synime për këtë luftë: eliminimin e Hamasit, kthimin e të gjithë të rrëmbyerve tanë dhe garantimin që Gaza të mos bëhet më një kërcënim për shtetin e Izraelit", tha Netanyahu në një deklaratë

drejtuar vendit. "Qytetarë të Izraelit: vazhdojmë deri në fund - deri në fitore. Asgjë nuk do të na ndalojë dhe ne jemi të bindur se kemi fuqinë, forcën, vullnetin dhe vendosmërinë për të arritur të gjitha qëllimet e luftës dhe do ta bëjmë".




## Dhjetëra pengje izraelite dhe të huaj të liruar gjatë tri ditëve armëpushim

GAZA, 26 NËNTOR - Autoritetet izraelite thonë se ndihmat në Rripin e Gazës po vazhdojnë të futen në rajon ndërsa palestinezët po mundohen të shijojnë disa momente normaliteti pas disa javë luftimesh të ashpra. Grupi më i fundit i pengjeve të liruara izraelite mbërriti tashmë në Izrael në orët e para të mëngjesit të së dielës dhe autoritetet e spitalit që ka marrë përsipër trajtimin e tyre thanë se ata do të mbahen nën mbikëqyrje edhe pse nuk kanë dhënë shenja se kanë nevojë për trajtim urgjent.

Në ditën e dytë të armëpushimit, Hamasi liroi edhe 17 pengje të tjerë, 13 gra dhe fëmijë izraelitë si dhe katër tajlandezë. Një mjek izraelit tha të dielën se pengjet e liruara të shtunën në mbrëmje janë në gjendje të mirë shëndetësore, por do të mbahen nën mbikëqyrjen e mjekëve. "Jam i lumtur të them se pavarësisht nga kushtet e vështira në të cilat ata kanë qenë dhe përvoja në rastet e pengmarrjeve, ata nuk kishin nevojë për ndonjë ndërhyrje mjekësore urgjente", thotë dr. Itai Pessach, drejtor i Spitalit të Fëmijëve Edmond dhe Lily Safra.

Banorët e lagjes Be'eri, një nga më të shkatërruarat gjatë sulmit terrorist të 7 tetorit, të cilët u evakuuan në një vendpushim afër Detit të Vdekur, pritën me entuziazëm mbërritjen e pengjeve në Izrael mëngjesin e së dielës.

Të dielën ushtria izraelite publikoi imazhet e 9-vjeçares Emily Hand duke vrapuar në krahët e babait të saj, Tomit, ndërsa u kthye në Izrael pas 50



ditësh e mbajtur peng në Rripin e Gazës. Krahas saj u lirua edhe Hila Rotem-Shoshani, nëna e së cilës mbetet një nga pengjet e Hamasit në Gazë. "Lirimi i Emily Handit është me rëndësi të madhe për mua sepse, për fat të keq, jam unë ai që i tha babait të saj se ajo ishte vlarë. Një javë më vonë isha sërish unë ai që i thashë babait të saj se ndoshta ajo është gjallë dhe po mbahet peng. Lirimi i saj është një lehtësim për mua. Dua t'i të përqafoj babanë e saj dhe t'i kërkoj falje sërish", thotë Amit Solve, kryetar i lagjes Be'eri në pjesën jugore të Izraelit.

Disa prej të liruave nuk kanë një vend të kthehen pasi Hamasi u dogji shtëpitë më 7 tetor. "Ata kanë një komunitet që do t'i mbështesë

sikurse do të bëjë i gjithë kombi kur të kthehen".

Pak kilometra më tutje, në Bregun Perëndimor, mijëra vetë festuan pasi Izraeli liroi 39 palestinezë, kryesisht gra dhe të mitur me tyre edhe Israa Jaabisin. Ajo ishte dënuar me 11 vjet burg nën akuzat për përpjekje për të kryer një sulm terrorist me makinë bombë në vitin 2015, sulm gjatë të cilit ajo pësoi lëndime të mëdha në fytyrë.

Ndërkohë në Rripin e Gazës banorët thonë se armëpushimi i përkohshëm po u mundëson të shijojnë disa "momente të humbura" normaliteti.

Ibrahim Kaninch aktualisht jeton në shtëpinë e tij pjesërisht të shkatërruar nga lufta në Khan

Younis. "Po jetojmë disa ditë qetësie. Përpara armëpushimit nuk ishim në gjendje të qëndronim jashtë për shkak të goditjeve dhe bombardimeve të shtëpive apo dhe nga zhurmat e avionëve", thotë Kaninch.

Autoritetet izraelite kanë vazhduar të publikojnë imazhe të kamionëve me ndihma humanitare që hyjnë në pjesën veriore të Gazës, ku janë zhvilluar edhe luftimet më të ashpra prej 7 tetorit. Kamionë me ndihma dhe karburante vazhdojnë të futen edhe nga vendkalimi kufitar egjiptian, Rafah.

Katari në anën tjetër ka publikuar për herë të parë zyren prej nga thonë se kryen negociatat mes Izraelit dhe grupit militant

palestinez Hamas. Gjatë pamjeve filmike shihen diplomatët e Katarit duke punuar në dhomën e operacioneve në Doha e tek mbajnë në vëzhgim armëpushimin dhe lirinë e pengjeve. Po kështu ka linja komunikimi të drejtpërdrejta dhe në kohë reale me Izraelin, zyren politike të Hamasit në Doha dhe Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.

Katari, Egjipti dhe Shtetet e Bashkuara po ushtrojnë trysni që armëpushimi të shtyhet përtej së hënës, por nuk është ende e qartë nëse një gjë e tillë do të ndodhë. Izraeli ka thënë se është i gatshëm ta shtyjë armëpushimin për një ditë më shumë për çdo 10 pengje izraelite të liruara nga Hamasi.

## Sondazhi, 69 % hebrejve britanikë po e konsiderojnë largimin nga Britania e Madhe

LONDËR, 26 NËNTOR - Më shumë se gjysma e hebrejve britanikë kanë konsideruar largimin nga Britania e Madhe për shkak të antisemitizmit që po hasin pas sulmeve të Hamasit më 7 tetor.

Të dhënat janë konfirmuar nga një studim i Fushatës kundër Antisemitizmit. Sipas

sondazhit, 69 % e hebrejve britanikë pranuan se aktualisht kishin më pak gjasa të shfaqnin shenja të dukshme të judaizmit të tyre. Sondazhi thekson se më shumë se 6 nga 10 hebrej britanikë ose kanë përjetuar personalisht ose kanë qenë dëshmitarë të një incidenti antisemitik që nga 7 tetori,

ose njohin dikë që e ka pasur.

Gjetjet e studimit sugjerojnë se vetëm 16 % e hebrejve britanikë besojnë se policia e trajton krimin antisemitik të urrejtjes si format e tjera të kriminit të urrejtjes, ndërsa dy të tretat besojnë se oficerët punojnë me standarde të dyfishta.





# Në Podujevë inaugurohet shtatorja e ikonës kombëtare Adem Demaçi

Në Podujevë të dielën është bërë zbulimi i shtatores së veprimtarit të çështjes kombëtare, Adem Demaçi. Në këtë ngjarje të pranishëm ishin edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kryetari i Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ish-presidenti Fatmir Sejdiu, deputetë, veprimtarë të çështjes kombëtare, si dhe familja e Demaçit. Në zbulimin e shtatores u tha se Demaçi ishte personalitet unik, i cili punoi deri në frymën e fundit për lirinë dhe pavarësinë e popullit të tij duke sakrifikuar jetën në shërbim të kauzës jetësore për liri

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**PODUJEVË, 26 NËNTOR** - "Sot jemi mbledhur për një homazh më shumë e për një imazh më të ngurtë të njeriut tonë të madh politik, Adem Demaçit, shkrimtarit, Adem Demës, njeriut të popullit, bacës Adem. Personalitet unik, në veprimin dhe me gjuhën e tij, në vetëmohimin për të tjerët dhe në

sepse këta janë dy binarët ku mbështetet treni ynë i historisë. "Heroi mund të jetë i vetëm në jetë, por nuk është kurrë jetim në histori. Me këtë intuitë që përbashkon poetin dhe luftëtarin, vullneti i Adem Demaçit e mban lehtë një të tretën e jetës në burg", tha kryeministri dhe shtoi se Adem Demaçi e ngrre lirinë e vet mbi gjerësinë e trojeve, mbi geografinë e vullnetit.



shqipen tonë të dashur", kështu e nis fjalën e tij kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në ceremoninë e zbulimit të shtatores së Adem Demaçit në Podujevë.

Më tej, kryeministri Kurti tha se për ne, si ndjekës të përpjekjeve të tij, do të jetë gjithnjë e vështirë të përkufizojmë personalitete të kësaj përmase, por na duhet t'i përkufizojmë në gjuhë e në gur,

"Gëzuar të gjithëve e secilit 28 Nëntori i Flamurit dhe i Pavarësisë! Përgëzime për këtë përmendore për të përvuajturin tonë më të fortë, për përvojën më të madhe të dashurisë për liri", tha kryeministrit në fund të fjalës së tij.

Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka theksuar se sot janë tubuar në Llapin e bacës Adem në prag të festës



kombëtare të 28 Nëntorit, për ta zbuluar shtatoren e njërit prej veprimtarëve më të mëdhenj që ka pasur populli shqiptar në histori, bacës Adem Demaçi. "Këtij luftëtar që punoi deri në frymën e fundit për lirinë dhe pavarësinë e popullit të tij, që sakrifkoi jetën e tij në shërbim të kauzës jetësore për liri, drejtësi dhe bashkim. Jam i lumtur që

Podujeva është qyteti i parë që do ta ketë shtatoren e bacës Adem. Podujeva është e nderuar që tashmë, në zemër të qytetit, në bulevardin e qytetit, ka personalitet dhe një figurë kaq madhështore. Adem Demaçi është një shqiptar i jashtëzakonshëm, i papërsëritshëm, veprimtar i pakrahasueshëm. Lum ne që e

patëm dhe e kemi sot të skalitur në zemër të qytetit", ka thënë Bulliqi.

Në fund të ceremonisë u bë edhe zbulimi i shtatores së veprimtarit Adem Demaçi.

Adem Demaçi ishte veprimtar që luftoi për kauzën kombëtare dhe për angazhimin e tij politik. Ai vuajti 28 vjet burgim në burgjet e Jugosllavisë.







# Saga pa fund e sigurimeve shëndetësore në Kosovë

Edhe pse procesi kishte nisur një dekadë e gjysmë më parë, banorëve të Kosovës ende nuk u ofrohet sigurim shëndetësor publik. Besim Kodra nga Shoqata e të Drejtave të Pacientëve të Kosovës thotë se mungesa e sigurimeve shëndetësore është shkelje e të drejtave të pacientëve. Sipas tij, institucionet e Kosovës kanë neglizhuar proceset që do t'i finalizonin sigurimet shëndetësore dhe jetësimi i tyre do të marrë vite kohë. Edhe në Raportin e sivjetmë të Progresit të publikuar nga Komisioni Evropian thuhet se një e treta e popullsisë së Kosovës ka qasje të kufizuar në shërbimet e kujdesit shëndetësor

**PRISHINË, 26 NËNTOR** - Edhe pse procesi kishte nisur një dekadë e gjysmë më parë, banorëve të Kosovës ende nuk u ofrohet sigurim shëndetësor publik. Pritja mund të zgjasë edhe më, pasi që për realizimin e këtij projekti fillimisht duhet të funksionalizohet Sistemi Informativ Shëndetësor. Besim Kodra nga Shoqata e të Drejtave të Pacientëve të Kosovës thotë se në skenarin më të mirë të mundshëm, ky proces mund të përfundojë pas pesë vjetësh. Ai cilëson se mungesa e sigurimeve shëndetësore është shkelje e të drejtave të pacientëve. “Në opsionin më optimist të mundshëm, duhen pesë vjet për t'i bërë sigurimet shëndetësore. Para se të nisnin sigurimet shëndetësore duhet të jetë lista e shërbimeve që ofron një institucion shëndetësor. Është çmimorja [që tregon] sa kushtojnë ato shërbime e shumë çështje të tjera të cilat nuk janë bërë”, thotë Kodra. Hulumtimet e bëra nga kjo shoqatë

tregojnë se rreth 84 për qind e pacientëve në Kosovë kanë vështirësi t'i marrin shërbimet shëndetësore për shkak të gjendjes financiare. Mungesa e sigurimit shëndetësor, thotë Kodra, godet më së shumti rastet sociale. Sipas tij, institucionet e Kosovës kanë neglizhuar proceset që do t'i finalizonin sigurimet shëndetësore dhe jetësimi i tyre do të marrë vite kohë. Edhe në Raportin e sivjetmë të Progresit të publikuar nga Komisioni Evropian thuhet se një e treta e popullsisë së Kosovës ka qasje të kufizuar në shërbimet e kujdesit shëndetësor. “Pabarazitë në shëndetësi mbeten problem serioz. Futja e skemës së sigurimeve shëndetësore universale është shtyrë vazhdimisht dhe pagesat nga xhepi [i qytetarëve] mbeten shumë të larta”, thuhet në këtë raport. Mungesa e sigurimeve, sipas Raportit të Progresit, ndikon në qasje më të ulët në shërbimet

thelbësore shëndetësore për ata që janë në situata të cenushme, siç janë ata që jetojnë në varfëri, në zonat rurale dhe personat që iu përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në Kosovë funksionon një numër i kompanive private të cilat ofrojnë sigurime shëndetësore për qytetarët. Nuk ka të dhëna se sa mund të jetë numri i qytetarëve të cilët kanë sigurim privat shëndetësor. Për herë të parë, Ligji për Sigurime Shëndetësore ishte miratuar në vitin 2007. Por, atëkohë, ai nuk hyri në fuqi pasi që shefi i atëhershëm i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), Joachim Rucker, nuk e nënshkroi atë. Pasi Kosova shpalli pavarësinë më 2008, qeveritë ndër vite e anashkaluan këtë ligj për shkak të, siç thuhet, implikimeve buxhetore. Vetëm në vitin 2014 Kuvendi i Kosovës arriti ta miratojë Ligjin e ri për Sigurime Shëndetësore, mirëpo as ky ligj nuk gjeti zbatim.

Zbatimit të këtij ligji ishte parashikuar se do t'i paraprinte një periudhë prej gjashtë muajve, gjatë së cilës do të mbledheshin premiumet (fondet). Mbledhja e fondeve ishte paralajmëruar se do të niste që nga 1 korriku i vitit 2017. Atëkohë Qeveria e Kosovës i kishte ndarë 17 milionë euro, të cilat më pas ishin tërhequr për t'u orientuar në një destinacion tjetër, përkatësisht për pagesat e pensioneve për veteranët e luftës.

## Pa Sistem Informativ Shëndetësor nuk mund të ketë sigurime shëndetësore

Para se të funksionalizohen sigurimet shëndetësore publike kërkohet funksionalizimi i Sistemit Informativ Shëndetësor. Sistemi Informativ Shëndetësor (SISH) bën gjenerimin, përpilimin, analizimin, komunikimin dhe përdorimin e të dhënave për sektorin publik dhe privat shëndetësor. Nga viti 2011 Ministria e Shëndetësisë kishte provuar fillimin e zbatimit të këtij sistemi në tri faza, të cilat synoheshin të realizohen deri në vitin 2020. Mirëpo ky sistem nuk është realizuar. Në seancën parlamentare më 16 nëntor, gjatë shqyrtimit të Projektligjit për Buxhetin e vitit

2024, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka thënë se tashmë ka nisur funksionalizimi i Sistemit Informativ Shëndetësor. Buxheti për sistemin e përgjithshëm shëndetësor për vitin 2024, ka thënë ministri Vitia, kap vlerën e 345 milionë eurove. Sipas të dhënave në Projektligjin e publikuar për buxhetin e vitit të ardhshëm, Qeveria e Kosovës ka ndarë rreth shtatë milionë euro për Sistemin Informativ Shëndetësor për vitin 2024. Gjithsej, i tërë projekti vlerësohet se do të kushtojë rreth 47 milionë euro. “Ky projekt shënon hapin e parë për themelimin e sigurimeve shëndetësore”, ka thënë Vitia. Ministri Vitia ka theksuar se për dekada ka pasur tentativa të dështuara për këtë projekt dhe miliona euro të shkuara dëm për shkak se nuk ka pasur analizë të këtij sistemi. “Në vitet pasuese do të ecim drejt kompletimit edhe të sistemit të sigurimeve shëndetësore”, ka thënë ai. Vitia ka sqaruar se për sigurime shëndetësore nuk do të ndahen mjete financiare nga buxheti i shtetit, por ato mjete do të mbledhen nga të ardhurat e secilit të punësuar dhe punëdhënësve. “Pra, kur sigurimet të startojnë, secili punëtor do të ndajë nga paga e vet një përqindje dhe secili punëdhënës do të ndajë për të punësuarit e vet një përqindje”, ka shpjeguar Vitia.



# Votimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, ajo me Danimarkën vlerësohet problematike në përmbajtje



**PRISHTINË, 26 NËNTOR** - Një sërë marrëveshjesh ndërkombëtare ia dolën të miratohen të enjten pasi që Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës u pajtua t'i mundësojë pushtetit kalimin e tyre. Megjithatë, jo të gjitha marrëveshjet morën votat e nevojshme, pasi disa u shtynë për seancat e ardhshme. Mes tyre, njëra që është komentuar shumë ka gjasë të dështojë në tërësi. Akuzat e kundërakuza u bënë për marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat kishin muaj që po prisnin për t'i marrë votat e nevojshme në Kuvend. Por, seanca e së enjtes solli paqe

mes pushtetit dhe një pjese të opozitës, duke i kaluar disa prej tyre. Marrëveshja e parë e cila është miratuar është ajo e "Rehabilitimit të linjës hekurudhore 10B". Pas saj, Kuvendi ka miratuar edhe Marrëveshjen e kredisë dhe projektin për projektin: Zhvillimi i sektorit të energjisë VII - përmirësimi i rrjetit të transmetimit. Po ashtu, është miratuar edhe Marrëveshja e Kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për rindërtim dhe zhvillim për Projektin "Ngrohtorja solare e

Prishtinës". Votën e deputetëve e ka marrë edhe Marrëveshja për bashkëfinancimin e bursave të arsimit të lartë në nivelin master në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ambasadës së Francës në Prishtinë. Kuvendi ka votuar edhe Marrëveshjen për projektin Mbështetja për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë në zonat rurale përmes diversifikimit të aktiviteteve. Por, në votim nuk u hodh fare Traktati ndërmjet Kosovës dhe Danimarkës për shfrytëzimin e

institucionit korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve daneze, pas polemikave të shumta mes ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu dhe deputetëve, kryesisht nga Lidhja Demokratike të Kosovës. Se kjo marrëveshje është problematike në përmbajtje dhe diskutimet po stërzgaten me të drejtë thotë Arbër Thaçi nga Instituti Demokratik i Kosovës. Sipas tij, gati e vetmja gjë pozitive prej saj është kostoja që Kosova përfiton. "Tiparet pozitive të kësaj marrëveshje, e vetmja gjë që mund të vlerësohet, është

përfitimi financiar që Kosova e ka nga ky traktat meqenëse përfiton afër 15 milionë euro në vit", ka thënë Thaçi. Përveç traktatit me Danimarkën, edhe tri marrëveshje ndërkombëtare nuk janë hedhur në votim, pasi në pjesën e dytë të seancës nuk pati kuorum. Votimi i marrëveshjeve ndërkombëtare u zhblllokua pasi përfundimisht votën për to e dhanë edhe deputetët e AAK-së, duke e lënë grupin parlamentar të PDK-së të vetmin që vazhdon kundërshtimin e votimit të tyre dhe nismave të pushtetit./Dukagjini/

## Krasniqi: Në Raportin e Progresit është përmendur 99 herë fjala korrupsion

**PRISHTINË, 26 NËNTOR** - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka thënë se në 133 faqet e Raportit të Progresit, 99 herë është përmendur fjala korrupsion. Ai në "Facebook" ka shkruar se korrupsioni është në institucione. "Në 133

faqe të Komisionit Evropian për Kosovën - 99 herë përmendet fjala korrupsion! Korrupsion institucional, pasurimi i zyrtarëve qeveritarë, varfëri qytetare e regres shtetëror!", ka shkruar Krasniqi. Në videon që e ka shpërndarë

ai thuhet se "korrupsioni është shqetësim serioz në Kosovë. Shkarkimi i Kreut të Njësisë së Veçantë të Hetimeve në kuadër të Policisë së Kosovës, dërgon një sinjal negativ në përkushtimin e Kosovës në luftën kundër korrupsionit".





# Asociacioni sipas këtij drafti e stimulon edhe më shumë konfliktin e armatosur

Milazim KRASNIQI

Pakicat kombëtare zakonisht rebelohen, në rastet kur qeveria e shumicës i privon nga pjesëmarrja në pushtet, i diskriminon në ndarjen e pasurisë, ua redukton liritë e të drejtat qytetare e kombëtare dhe u ngarkon barrë më të rëndë të obligimeve. Në rastin e pakicës serbe në Kosovë, kjo nuk ndodhë në asnjë segment. Serbët e Kosovës kanë pjesëmarrje joproporcionale në pushtet, duke pasur vende të rezervuara në parlament e në qeveri dhe komuna të formuara enkas për t'u qeverisë prej tyre. Pjesëmarrja e tyre në buxhet është pakrahasimihet më e lartë se sa kontributet për akumulimin e buxhetit. Ndërsa si shembull sui generis është fakti se serbët e Kosovës nuk paguajnë as shërbimet që marrin, energjinë dhe ujën e shpenzuar. Nuk paguajnë taksa, përveç në të ardhurat që marrin nga qeveria e Kosovës. Po ashtu planprogramet shkollorë i kanë të shtetit të vet amë, të Serbisë, gjë që do të thotë se nuk ka asnjë tentativë nga qeveria qendrore që të kufizohen



liritë dhe të drejtat e tyre identitare e kombëtare. Kisha Ortodokse Serbe ushtron funksione të saj në Kosovë njësoj si në Shumadi ose në rajonin e Timokut. Me gjithë atë pjesëmarrje enorme në pushtet dhe me ato favorizime, serbët e Kosovës janë tërësisht të pakënaqur, në fakt janë të rebeluar ndaj shtetit të Kosovës. Pse? Sepse kërkesat dhe synimet e serbëve të Kosovës nuk janë kërkesa dhe synime të një pakice kombëtare. Kërkesat dhe synimet e tyre janë

për minimin dhe zhbërjen e shtetit ekzistues të Kosovës. Pra, ata në asnjë formë ende nuk janë pajtuar me faktin që janë shkëputur nga Serbia dhe jetojnë në shtetin e ri, në atë të Kosovës. Prandaj është rrezik t'u ofrohet ofertë gjeneroze si kjo e fundit për Asociacionin e Komunave me shumicë serbe, e cila i ka elementet e autonomisë territoriale-politike, funksionale, kulturore dhe personale. Ata mund ta marrin edhe ofertën e re

të Asociacionit-autonomisë, por nuk integrohen, siç nuk janë integruar as me formimin e komunave me shumicë serbe dhe me statusin e privilegjuar të Kishës Ortodokse Serbe. Nuk ka shans të ndalen kërkesat e tyre secesioniste as me Asociacionin e ri. Ideja që përmendi zonja Ashton se mendohej se ata do të lidheshin me Prishtinën nëpërmjet Asociacionit, është thjesht naivitet. Serbët e Kosovës e kanë një objektiv të qartë:

zhbërjen e shtetit të Kosovës dhe rikthimin e saj nën Serbi. Ky objektiv nuk ndryshon me qasjen që ka ndaj këtij problemi komuniteti ndërkombëtar, SHBA, BE, NATO. Kjo qasje vetëm sa po e ndihmon projektin e serbëve të Kosovës për ta minuar ekzistencën e Kosovës si shtet. Kjo qasje e SHBA, BE dhe NATO-s për formimin e Asociacionit, në fakt ka motivuar edhe rebelimin e armatosur në veriun e Kosovës të 24 shtatorit 2023.

E vëmja zgjidhje është rishikimi i qasjes së deritashme problematike të faktorëve ndërkombëtar, në këto pika: njohja e Kosovës si shtet nga të gjitha shtetet anëtare të NATO-s dhe të BE-së, kërcënimi me ndryshimin e Planit të Ahtisarit përkatësisht të Kushtetutës ahtisariane të Kosovës, në drejtim të ekuilibrit të të drejtave të serbëve dhe e treta, presionet e orkestruara mbi Serbinë, për ta eliminuar prej saj përdorimin subverziv të serbëve të Kosovës. Nëse nuk bëhen këto veprime, si me Asociacion si pa të, rreziku nga konflikti civil në veri të Kosovës është i pashmangshëm.

## Në Prekaz gjenden mbetje të tjera mortore që dyshohet se janë të të zhdukurve gjatë luftës



SKENDERAJ, 26 NËNTOR - Policia e Kosovës bëri me dije se në Prekazin e Poshtëm të Skenderajt hetuesit policorë, në koordinim me Komisionin Qeveritar për Persona të Zhdukur dhe Institutin e Mjekësisë Ligjore, kanë gjetur mbetje mortore edhe të tre personave. Në fillim të këtij muaji në po këtë lokacion ishin gjetur mbetje mortore të tre personave të tjerë. Policia tha se dyshohet se mbetjet mortore u përkasin personave të zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë. "Më datë 9 nëntor 2023 janë gjetur skelete të tre trupave. Hulumtimet kanë vazhduar edhe ditëve në vazhdim, kështu më 20, 21 dhe 24 nëntor 2023 janë hasur gjetje edhe të tre personave të tjerë. Pra, gjatë gërmimeve në këtë lokacion janë gjetur dhe më pas janë tërhequr nga ekipet e

Institutit të Mjekësisë Ligjore gjithsej trupa [gjetje eshtërore] të gjashtë personave që dyshohet të jenë trupa të zhdukur gjatë luftës së fundit", u tha në njoftim. Autoritetet bënë me dije se hulumtimet në këtë lokacion konsiderohen të mbyllura. Në luftën e zhvilluar në Kosovë më 1998/99 janë vrarë mbi 13 000 civilë. Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë. Më 2 maj Kosova dhe Serbia - nën ndërmjetësim të Bashkimit Evropian - kanë arritur marrëveshje për një Deklaratë për Personat e Zhdukur. Bekim Blakaj nga Fondi për të Drejtën Humanitare ka thënë se një vendim i tillë jep shpresë për qasjen në dokumentet e shënjuara si "konfidenciale".

## Policia po i heton dyshimet për shpërthimin e një granate në veri

MITROVICË, 26 NËNTOR - Policia e Kosovës ka thënë të dielën se e ka hapur një rast hetimi për dyshimet e shpërthimit të një granate dore në Mitrovicë të Veriut pak pas mesnatës. Nuk ka të lënduar nga ky shpërthim, tha për "Radion Evropë e Lirë" zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani. Granata dyshohet të ketë shpërthyer në rrugën "Perandori Dushan" dhe ka shkaktuar "dëme të vogla

materiale në dritare të një shtëpie", sipas Elshanit. "Njësitë kompetente policore kanë dalë në vend të ngjarjes. Policia, pas konsultimit me prokuror, ka hapur rastin shkaktim i rrezikut të përgjithshëm", theksoi Elshani. Gjendja në veriun e Kosovës, vendi i banuar me shumicë serbe, vazhdon të jetë e tensionuar prej fillimit të këtij viti, kur serbët lokalë i kundërshtuan kryetarët shqiptarë në katër komunat

me shumicë serbe, të cilët dolën nga zgjedhjet e bojkotuar nga serbët në prill. Më 24 shtator gjendja u përshkallëzua pasi Policia e Kosovës u sulmua nga një grup i armatosur i serbëve në fshatin Banjskë të Zveçanit, ku mbeti i vrarë polici Afrim Bunjaku. Gjatë përleshjeve që pasuan u vranë edhe tre sulmues serbë. Kosova ka fajësuar Serbinë për sulmin, por Beogradi ka mohuar përfshirjen në të.





# Fondi Sovran dëmton konkurrencën, investimet private, ndërmarrjet publike dhe buxhetin e shtetit



**Shkruan: Avdullah HOTI**

I gjithë legjislacioni ekonomik i Kosovës, i miratuar nga viti 2008 e kënde, është bazuar në parimet e ekonomisë sociale të tregut, me besimin se tregu dhe konkurrenca janë e vetmja mënyrë për zhvillim ekonomik afatgjatë e të qëndrueshëm. Ndërkaq, bazuar në Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, nga viti 2016 e kënde, Kosova ka qenë e obliguar të harmonizojë legjislacionin ekonomik me BE-në për tu mundësuar bizneseve kosovare të përballen më lehtë me konkurrencën në tregun evropian, përfshirë heqjen graduale të taksave doganore me BE-në si hap konkret drejt unifikimit të tregjeve.

Përtej këtyre, Kosova ka krijuar mekanizmat institucionalë për të mbështetur bizneset private, ku përfshihen: (i) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, i cili mundëson kreditim më të lehtë të

bizneseve nga bankat komerciale, duke promovuar sektorë të caktuar në përputhje me strategjinë kombëtare për zhvillim; (ii) Autoriteti i Konkurrencës që kujdeset për të parandaluar veprimet në treg që kufizojnë konkurrencën e lirë; (iii) Komisioni për Ndihmë Shtetërore, i cili mbikëqyrë ndërhyrjen e Qeverisë në ekonomi përmes subvencioneve me qëllim që mos të shtrembërohet konkurrenca e lirë; (iv) Agjencitë për mbështetje të ndërmarrësisë dhe investimeve, (v) Parqet biznese dhe zonat ekonomike të nivelit qendror dhe lokal etj.

Themelimi i Fondit Sovran do të jetë një hap i madh prapa në ambientin e të bërit biznes. Të gjitha analizat vlerësojnë se do të dëmtohet konkurrenca e lirë e do të krijohet pasiguri për buxhetin e shtetit. Në çdo nen të tij, Ligji për Fondin Sovran dhe koncepti dokumenti përkatës kanë për bazë ideologjinë ekonomike që është e kundërt me liberalizmin ekonomik.

Në vijim janë vërejtjet kryesore dhe problemet ekonomike që shkakton Ligji për Fondin Sovran.

1. Qeveria i shpall disa kompani private si "Kampionë Nacionalë", në të cilat investon Fondi Sovran. Pra, Qeveria përcakton se cilat

kompani private përfitojnë nga investimet e Fondit. Ky veprim e kufizohen drejtpërdrejt konkurrencën e lirë. Për më tepër, kjo qasje paraqet kapje të sektorit privat nga Qeveria sipas modelit kinez të kapitalizmit shtetëror.

2. Ndërmarrjet publike në kuadër Fondit Sovran mund t'i japin hua njëra tjetrës. Kjo politikë ekonomike është reminishencë e komunizmit, ku ndërmarrjet shtetërore të atëhershme e financin njëra-tjetrën derisa i gjithë sistemi ekonomik dhe financiar i asaj kohe kolapsoi nga joeficiencat masive.

3. Edhe pse Fondi Sovran thuhet se do të jetë institucion i pavarur, ligji përcakton se çdo veprim strategjik i Fondit bëhet në koordinim me Qeverinë, që nga përgatitja e strategjisë investive të Fondit, përcaktimit të listës së aseteve nën menaxhim të Fondit, certifikimit të "Kampionëve Nacionalë" siç u definuar në pikën 1 më lartë, e deri tek vendimet specifike. Kështu që, Fondi Sovran është vetëm instrument i Qeverisë për të kontrolluar ndërmarrjet publike dhe për të favorizuar ndërmarrje të caktuara private. Kjo mund të vërehet edhe me faktin se Kuvendi i Kosovës,

përmes mazhorancës qeverisëse, parashihet të ushtrojë detyrat e kuvendit të aksionarit të Fondit.

4. Fondit Sovran do t'i transferohen ndërmarrje që aktualisht janë nën menaxhimin e Qeverisë dhe Agjencisë së Privatizimit. Me këtë rast, ato ndërmarrje i nënshtrohen "ristrukturimit". Por, problemi qëndron se kjo mazhornacë majtiste që është në pushtet, ristrukturimin e kupton vetëm si ndryshim të Bordit, e jo ndryshim të kapitalit, operacioneve, prodhimit/shërbimit, zinxhirit të vlerës dhe ripozicionimit në treg të ndërmarrjes. Problem në vete është fakti se nëse ndërmarrjet që transferohen në Fond kanë borxhe, atëherë borxhet mbesin tek Qeveria dhe Agjencia e Privatizimit, duke e rritur barrën për shtetin.

5. Ndërmarrjet publike ekzistuese funksionojnë në tregje të rregulluara, me përjashtim të Trepçës dhe Telekomit që shesin produktet dhe shërbimet e tyre në tregje konkurrenca. Duke qenë të rregulluara, ndërmarrjet publike kanë strukturë dhe nivel të shpenzimeve të përcaktuara nga rregullatorët përkatës, të cilat bazohen në kostot e produkteve dhe shërbimeve që ofrojnë. Në shumicën e rasteve, çmimi që paguajnë konsumatorët

përcaktohet nga rregullatorët përkatës, e jo nga tregu i lirë. Kjo e vë në pikëpyetje idenë e komercializimit klasik të këtyre ndërmarrjeve, dhe, rrjedhimisht, arsyeshmërinë e përfshirjes së tyre në Fond.

6. Shembujt në të cilët bazohet Fondi Sovran nuk vlejnjë për Kosovën, si ekonomi e tregut të lirë dhe e orientuar drejt tregut evropian. Rasti i Sllovenisë e ka vërtetuar këtë, ku barra për buxhetin e shtetit nga mbajtja e ndërmarrjeve në pronësi të shtetit është bërë e papërbalueshme dhe shumë nga ato ndërmarrje kanë mbetur prapa konkurrencës sa i përket teknologjisë. Kosova nuk ka teprica buxhetore, siç është rasti i disa vendeve, të cilat teprica do të mund të investoheshin në këtë Fond.

7. Neni 7.3 specifikon se Fondi ushtron veprimtarinë në kushte të barabarta të tregut. Por të gjitha aranzhimet në kuadër të ligjit përcaktojnë se ky Fond është mbi: ligjin për shoqëritë tregtare, ligjin për AKP-në, ligjin e prokurimit, ligjin e punës dhe ligjin për ndërmarrjet publike. Këto aranzhime ligjore për Fondin Sovran nënkuptojnë se po krijohet një entitet që nuk do të përfill parimet bazike të rregullativës ekonomike.

## Prodhimi i energjisë bie, konsumi rritet



Sipas të dhënave, rritja e konsumit është shkakuar nga sektori i industrisë dhe nga përdorimi komercial i rrymës.

### Kush konsumon më shumë energji elektrike?

Në shtator të vitit 2023 energjia elektrike e konsumuar për përdorim komercial dhe për industri u rrit dukshëm në krahasim me energjinë e konsumuar gjatë shtatorit të vitit paraprak. Trendi i konsumit ka ndryshuar vazhdimisht në Kosovë, ndërsa arriti në vlerat më të larta gjatë janarit të këtij viti dhe atij vitit të kaluar.

Sasia e energjisë elektrike të konsumuar, gjatë periudhës nga janari i vitit 2022 e deri më shtator të vitit 2023, ka ndryshuar vazhdimisht. Mirëpo, asnjëherë nuk ka kapërcyer 561 megavate në orë, sa ishin konsumuar gjatë janarit të të dyja viteve.

Për t'i mbuluar kërkesat për energji elektrike, Kosova ka importuar vazhdimisht rrymë. Sasia e energjisë elektrike të importuar e ka tejkaluar shifrën e rrymës së eksportuar. Që nga janari i vitit 2022 Kosova ka importuar më shumë energji elektrike sesa që ka prodhuar çdo muaj, përveç gjatë periudhës prill-shtator të vitit 2022.

**PRISHTINË, 26 NËNTOR** - Dimrat e fundit në Kosovë janë përcjellë me furnizim të çrregullt të energjisë elektrike, shtrenjtim të rrymës dhe thirrje nga Qeveria e Kosovës për kursim.

Teksa muajt e dimrit po afrohen, të dhënat e publikuara më 22 nëntor nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) tregojnë se prodhimi i energjisë elektrike gjatë muajit shtator të këtij viti ka rënë në krahasim me rrymën e prodhuar gjatë së njëjtës periudhë të vitit paraprak.

Gjatë muajit shtator të vitit 2023 u

prodhuar më pak energji elektrike në vend në krahasim me energjinë e prodhuar gjatë muajit shtator të vitit paraprak.

Në prill të këtij viti Korporata Energjetike e Kosovës dhe kompania amerikane General Electric kishin nënshkruar një marrëveshje për modernizimin e turbinave me avull të termocentralit Kosova B.

Ky projekt - që kushton rreth 50 milionë euro dhe pritet të përfundojë deri në vitin 2026 - pritet t'i risë kapacitetet prodhuese me energji elektrike.

Vitet e fundit sasia e energjisë së prodhuar ka ndryshuar nga muaji në muaj. Të dhënat më të reja tregojnë se, gjatë shtatorit të sivjetmë, prodhimi i energjisë nga termocentralet ka rënë në shifrën më të ulët në të paktën dy vjet. Për muajin tetor nuk janë publikuar ende të dhënat.

### Energjia e prodhuar nga termocentralet, hidrocentralet, era dhe dielli

Në Kosovë përqindja më e

madhe e energjisë elektrike të prodhuar në vend vjen nga termocentralet. Megjithatë, sasia e prodhuar ka ndryshuar nga muaji në muaj.

Për dallim nga sasia e energjisë së prodhuar, konsumi i energjisë elektrike është rritur. Të dhënat e ASK-së tregojnë se gjatë muajit shtator të vitit 2023 u konsumua më shumë energji elektrike sesa gjatë shtatorit të vitit 2022.

Gjatë muajit shtator të vitit 2023 është konsumuar më shumë energji elektrike sesa gjatë të njëjtë muaj të vitit paraprak.



PROFIL

# Vdekja nuk është fundi për Zef Dedën!



Kinematografia shqiptare ka humbur një prej aktorëve të saj më të shquar, të madhin Zef Deda që është ndarë nga jeta në moshën 73-vjeçare.

Lajmi i trishtë është konfirmuar nga dy djemtë e tij, Julian dhe Mario Deda. Mësohet se aktori i mirënjohur ka ndërruar jetë në Shkodër, pasi luftonte prej kohësh me një sëmundje të rëndë.

Zef Deda, lindi në qytetin e Shkodrës më 27 korrik 1950, ku e nisi karrierën e tij në moshë të re pranë Teatrit Migjeni.

Me një karrierë të jashtëzakonshme që zgjati më shumë se 40 vjet, Deda

bëri emër me performancat e tij të jashtëzakonshme në skenë dhe kontriboi ndjeshëm në zhvillimin e humorit shqiptar.

Artisti u largua nga Shqipëria për një periudhë gjashtëvjeçare për shkak të emigrimit, por kthimi i tij në atdhe në vitin 1996 i gjeti fansat e komedisë duke e pritur me padurim.

Zef Deda ishte i martuar me Rozina Dedën, dhe bashkë kanë dy djem, Marion dhe Julianin, i cili është gjithashtu aktor i njohur i humorit në Shqipëri.

Ndërsa komuniteti artistik dhe dashamirësit e teatrit shprehin

ngushëllimet e tyre, vepra dhe kujtimi i Zef Dedës do të mbeten të pavdekshme në zemrat dhe mendjet e shumë shqiptarëve që u rritën dhe u frymëzuan nga shpirti dhe fryma e tij e paharrueshme.

## Karriera e Zef Dedës:

Zef Deda është një nga komedianët më të mirë të Shqipërisë, i cilësuar edhe si Charlie Chaplin i Shqipërisë. Lindi në Shkodër më 27 korrik 1950. Është shkolluar në qytetin e tij të lindjes, dhe në politeknikumin e ndërtimit në Tiranë.

Fillon shkollën e lartë për gjuhë –

letërsi, por nuk e mbaron dot për arsye shëndetësore. Ka punuar për më shumë se 40 vite në Teatrin Migjeni të Shkodrës.


Talenti i tij spikat që në moshë të vogël. Me një shkathhtësi dhe me një plastikë të shkëlqyer psiko-fizike ai arrin të realizojë qindra figura artistike. Prandaj dhe është mjaft i dashur për publikun shqiptar, sidomos atë Shkodran.

Pas një shkëputje prej 6 vitesh, për shkak të emigrimit jashtë atdheut, ai kthehet në vitin 1996 në Shqipëri për të ushtruar profesionin e aktorit, të cilin e vazhdon me shumë sukses. Zef Deda gjithashtu ka interpretuar

edhe shumë komedi si: “Vëllai nga babai”, “Kollovari”, “Big Brother Shkodra 1”, “Big Brother Shkodra 2”, etj.


## Disa nga rolet e Zef Dedës:

Kunati i shokut Xhemal, Kola i dritave, Charlie Chaplin (imitim), Kuseriri nga Amerika, Altini (altufi) Dhjetra emisjone për fëmijë, Ne filmin “gjurmë në kaltersi” 1981, etj.





# Fjalët e fundit të Gjon Destanishës, para ekzekutimit në Prishtinë: Rrnoftë Shqipnia, rrnoftë Flamuri kombëtar!



Gjon Destanisha me bashkëshorten Antonina

## Nga: Bajram MJEKU

Ushtaraku në këtë fotografi është Gjon Lulash Destanisha – dhe bashkëshortja e tij Antonina Vas Kola – Destanisha – i cili në fund të viteve tridhjetë kishte gradën e kapitenit në Mbretërinë shqiptare dhe ishte komandant i Ushtrisë në Qarkun e Shkodrës.

Gjon Destanisha lindi në vitin 1900 në Gimaj të Shalës së Dukagjinit, ndërsa gjatë Luftës së Dytë Botërore, si ushtarak luajti rol të rëndësishëm edhe në Kosovë, por që askush nuk di si u arrestua nga partizano-çetnikët serbë dhe përfundoi në Burgun e Prishtinës – pasi në mungesë u dënua me vdekje. U ekzekutua në vitin 1951 nga serbët, në moshën 51-vjeçare. Për herë të parë për Gjon Destanishën kam dëgjuar në vitin 2016, kur më ranë në duar kujtimet e Gjokë Spaçit nga Velezha e Prizrenit, i cili me Gjon Destanishën u takua në Burgun e Prishtinës. Gjokë Spaçi, së bashku me njëzetedy anëtarë të Grupit të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, në gusht të vitit 1950, në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë u dënuan me gjithsej 297 vjet burg, më saktë me tre shekuj burg të rëndë.

Kujtimet e Gjokë Spaçit i kam përmbledhur në librin me titull “Testamenti i fshehur”, ndërsa siç do të lexoni më poshtë, nuk kam bërë asnjë ndërhyrje, përfshirë këtu edhe dialektin gegë, kur Gjokë Spaçi i ka shkruar në gjysmën e parë të vitit 1973.

Me kalimin e kohës, kam hulumtuar se Gjon Destanisha ka marrë pjesë në aksionin për vrasjen e Emin Durakut në Ribar të Madh të Lypjanit, më 23 dhjetor të vitit 1942, derisa më 7 korrik të vitit 1952 Lidhja Komuniste e Jugosllavisë e

dekoroi Emin Durakun me urdhrin Hero i Popullit!

Gjon Destanishës i kishte rënë shorti për atentatin ndaj Miladin Popoviçit. Ishte i gatshëm ta bënte këtë, por meqë Haki Taha kishte sëmundjen e tuberkulozit dhe pasi besonte se brenda pak muajsh do të ndërronte jetë, ai u zotua që vet ta kryente atentatin kundër Miladin Popoviçit, të cilin edhe e vrau më 13 mars të vitit 1945 në Prishtinë.

Në vazhdim, lexoni fragmentet e kujtimeve të Gjokë Spaçit se si e përshkruan personalitetin e Gjon Destanishës në njërin anë dhe, në anën tjetër, sa e dhimbshme është se si në vija ideologjike shqiptarët ishin dhe vazhdojnë të jenë të ndarë – deri në armiqësi. Fatkeqësisht, e majta është e fuqishme edhe sot në botën shqiptare!

Nacionaldemokrati Gjokë Spaçi e kujton Gjon Destanishën kështu:

Aty gjetëm edhe një antikomunist të betuem, por fatkeqësisht që jetëshkurtë. Ai ishte kapiten, Gjon Destanisha. Mendoj se ashtu e kishte ngallëpin, por shokët e tij të mjerë, në rast se ndonjeni nga ata janë gjallë, do t’ia dinin saktë ngallëpin. I ndjeri ishte dënue me vdekje dhe ia kishin vnu prangat në secilën kambë nga 25 kg. Ia kishin caktue vendin afër derës. Ndoshta kjo ndodhi që të mos ua prishte gjumin dhe qetësinë të burgosunve nga ato vegla qorre të Drejtoratit të burgut. Kur e pyetëm pse je vendos këtu te dera, ai na tha se vet e ka zgjedhë këtë vend, që të mos ua prishë qetësinë të burgosunve me rropamat e hekurave!

Më lejo zotni lexues, që t’i shkruaj pak fjalë për këtë burrë të martirizuem, mbasi për Kosovën tonë, ai ishte prej Shqipnisë së Vjetër. Gjon Destanisha, ky martir i atdheut, në kohën e Shqipnisë

kishte pas qenë kapiten i Ushtrisë shqiptare. Bashkë me një togë ushtarësh, xhandarësh dhe me do ballistë kishte pas shkua në katundin Suhodoll ku e kishin patur qerdhen komunistët e drazhistët dhe aty e kishte pas krye një aksion të madh. Se si ishte arrestua nuk e dinim hollësisht, por atë e kishin dënue me vdekje. Gjykimi i tij, domethanë qëndrimi i tij gjatë gjykimit, ishte shumë burrnor e i pathyeshëm. Ashtu qëndroi deri natën e fundit të jetës së Tij.

Gjon Destanisha u jipte kurajë të gjithë të burgosunve. Të gjithë të burgosunit shqiptarë, përveç komunistëve, ibeistëve dhe spiunave, përpara se të shkojmë ne, e kishin dashtë dhe përkrah si vëllaun e vet. Të gjitha gjanat ushqimore që u kishin pas ardhë të burgosunve, prej më të mirave ia kishin pas dhanë kapiten Gjonit. Si mbërritëm në atë dhomë, Gjon Destanisha e ndjeu veten si të ishte në Kompaninë e vet. Ai ndjeu sikur i erdhi Ushtria shqiptare e vendosur për vdekje. Bisedat e tij ishin plot ideal dhe në çdo fjalë na thoshte:

– Djema, mos u mërzitni se keni me ja mbërritë qëllimit!

Po e shkurtoi këtë bisedë të zotni Kapetanit. Nji natë në ora nji mbas mesnate, kur të gjithë të burgosunit ishin në atë gjumin e mallkuem, u hap dera. Brenda hynë tre civilë dhe me za të vogël e çuen Gjonin prej gjumi. I thanë hajde se po të thërrasin në Drejtori, sepse ka ardhë vendimi në interes tandin. Unë thashë se kjo ndodhi kur ne ishim në gjumë, por lexues i dashtun, gjumi në ato vende asht si gjumi i peshkut në ujë. Gjithmonë fle syçelë. Kur ata të mallkuem hynë në dhomë, sytë tonë panë dhe veshët na dëgjuan si fjalët e të mallkuemve ashtu edhe fjalët e

pastë Shpirti i Tij.

E rrëmbyen rebelçe. E nxorën prej dhome dhe e mbyllën derën. Afër derës në koridor e kishin pas sjellë farkatarin me ia thye prangat. Të rrahurat e çekiçit u ndien disa herë, pastaj u dëgjuan edhe fjalët e Gjonit:

– O maxhup, sill ma mirë!

Kur dolën në oborrin e burgut, i dëgjuem edhe dy herë fjalët e Gjonit:

– Rrnoftë Shqipnia! Rrnoftë Flamuri kombëtar! – tha ai me za të naltë. Kur deshti të thotë për të tretën herë fjalën: Rrno ... sigurisht e ngulfatën në fyt e i mbeti fjala në grykë posa e filloi. Mbas pesë minutash u dëgjuan dy rafale të mitralozit mbas murit të burgut dhe kaq e patëm me Gjonin.

Lexues i dashtun! Ktheje kujtimin mbrapa e shikona neve në atë moment. Fytyra e të gjithë nacionalistave, ishte si flaka e qiririt. Lotët derdheshin prej syve tanë si shiu prej qielli. Jo vetëm prej neve, por prej të gjithë shqiptarëve që ishin në atë dhomë, përveç stalinistëve shqiptarë. Tri apo katër ditë nuk kemi hangër bukë. Jo prej frikës, por prej dhimbjes që e humbëm atë idealist, atë burrë me të gjitha njisinat kombëtare shqiptare ...

Mbas Luftës së Dytë Botërore, bashkëshorten e Gjonit, Antoninën, tri vajzat dhe djalin e saj, regjimi stalinist i dërgoi në internim njëzetepesë vjet me radhë. Antonina ndërroi jetë në nëntor të vitit 1987 në Shkodër.

Fotografinë e kapiten Gjon Destanishës dhe bashkëshortes Antoninës, ma ka dërguar nipi i tij, Gjon Destanisha Jr. i cili tash disa vjet jeton e punon në Nju-Jork. /Telegrafi/





**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Invert  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



## Ylli regjistron fitoren e pestë radhazi, Vëllaznimi të gjashtën

### “Epoka e re”

**SUHAREKË, 26 NËNTOR** - Golden Eagle Ylli po kalon në formë shumë të mirë. Therandasit arritën fitoren e pestë radhazi, duke mundur Sigal Prishtinën me rezultat 100:80 (26:24, 17:18, 33:19, 24:19). Bardhekaltrit e nisën ndeshjen shumë më mirë dhe që në fillim krijuan epërsi prej 12 pikësh, 7:19, por vendasit dalëngadalë u rikthyen dhe e fituan çerekun e parë 26:24. Therandasit vazhduan me lojë të mirë, duke pasur epërsi 6-7 pikë, por kryeqytetasit nuk lejuan shkëputjen, ku pjesa e parë përfundoi 43:42. Periudha e tretë ishte vendimtare në këtë sfidë. Në këtë pjesë, vendasit ishin shumë



më të mirë, sidomos në efikasitet dhe e fituan bindshëm këtë pjesë, ku rezultati pas 30 minutash ishte 76:61. Në dhjetë minutat e fundit nuk kishte ndonjë ndryshim të madh dhe therandasit fituan me

20 pikë dallim, 100:80. Te vendasit u dalluan Gëzim Morina me 18 pikë, tre kërcime dhe shtatë asistime dhe Jalen Nesbitt me 18 pikë e 11 kërcime, kurse te mysafirët u dalluan Muhamedali

Janjeva me 15 pikë e gjashtë kërcime, Tyron Harris me 20 pikë dhe Shaheed Davis me 17 pikë. Golden Eagle Ylli ka gjashtë fitore e katër humbje, kurse Sigal Prishtina pesë fitore e katër humbje. Vëllaznimi në formë të jashtëzakonshme. Kuqezinjtë kanë shënuar fitoren e gjashtë me radhë, kësaj radhe duke mundur Proton Cable Prizrenin në udhëtim me rezultat 93:97 (23:29, 28:24, 23:26, 19:18). Çereku i parë ishte i barabartë deri në fund, kur mysafirët që kishin përkrahje nga një numër i konsiderueshëm i tifozëve me një seri prej 3:9, e fituan këtë pjesë 23:29. Megjithatë, vendasit u rikthyen shpejt dhe barazuan rezultat, ku periudha e dytë ishte e barabartë, ndërsa pjesa e parë përfundoi 51:53. Kuqezinjtë

e filluan furishëm periudhën e tretë, duke pasur epërsi deri në 14 pikë, 62:76, por prizrenasit sërish u rikthyen, duke zvogëluar epërsinë, ku rezultati pas 30 minutash ishte 74:79. Vëllaznimi sërish u shkëput në dhjetë minutat e fundit, në 82:93, por vendasit tentuan rikthimin e madh, duke afuar rezultat në 91:93, por kuqezinjtë ruajtën epërsinë dhe fituan 93:97. Më të mirët te prizrenasit ishin Ty Cockfield me 32 pikë, tri kërcime e gjashtë asistime dhe Urim Zenelaj me 15 pikë e 15 kërcime, ndërsa te skuadra nga Gjakova më i miri ishte Sammuell Sessoms me 33 pikë, gjashtë kërcime e dhjetë asistime. Proton Cable Prizreni ka dy fitore e shtatë humbje, ndërsa Vëllaznimi gjashtë fitore e katër humbje.

## Llapi arkëton tri pikë në Gjilan

**GJILAN, 26 NËNTOR** - Llapi ka shënuar fitore si mysafir në përballje me Gjilanin, në kuadër të javës së 15-të në Albi Mall Superligë. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin me bari sintetik në Gjilan është mbyllur me rezultat 2:0 në të mirë të llapjanve. Loja në përgjithësi ishte e baraspeshuar deri në minutat e fundit, por inkuadrimi në lojë i Ahmed Januzit rezultoi çelës i suksesit për skuadrën e Tahir Batatinës. Në fakt, ky futbollist asistoi tek të dy golat e shënuar nga Llapi. Fillimisht asistoi për Valmir Veliun, në minutën e 83-

të, derisa më pas e gjeti mjaft mirë Muhamet Hysenin, në minutën e 93-të, e ku me parabolë e mposhti portierin Betim Halimi. Pas kësaj fitoreje Llapi ngjitet në pozitën e dytë, me 28 pikë, 7 më pak se Ballkani. Ndërkohë përballja tjetër ndërmjet Prishtinës dhe Dritës që ishte paraparë të luhej sot në Kampin Nacional në Hajvali është shtyrë, shkaku i borës dhe akullit. Kjo ndeshje do të zhvillohet të hënën në orën 13:00 në stadiumin “Samë Kelmendi” në Lipjan. Në të njëjtin stadium të martën prej orës 13:00 luajnë

Fushë Kosova – Dukagjini, teksa ndeshja Feronikeli 74 – Liria luhet të hënën në orën 13.00 në Gjilan, në stadiumin me bari sintetik.

### SUPERLIGA - Java 15

**Të hënën takohen:**  
**13:00 Prishtina - Drita**  
**13:00 Feronikeli 74 - Liria**

**Të martën takohen:**  
**13:00 Fushë Kosova - Dukagjini**



## Spektakël hendbolli në Pejë, Rahoveci vazhdon me fitore

**Pejë, 26 nëntor** - Besa Famgas e Rahoveci kanë ofruar spektakël hendbolli të dielën mbrëma në palestrën “Karagaçi” në Pejë. Në kuadër të xhiros së 11-të të Superligës së Kosovës në hendboll është luajtur superderbi mes dy skuadrave aktualisht kryesore në vendin tonë. Ndeshja ishte shumë e fortë dhe shumë interesante nga fillimi e deri në fund. Të dy skuadrat kanë luajtur mbrojtje të fortë, ndërsa formë të lartë kanë shfaqur portierët, Arbër Curri e Art



Luzha te Rahoveci dhe Mursel Mehmeti te Besa Famgas. Ndeshjen dramatike e fitoi Rahoveci me rezultat 29:27. Rahoveci për herë të dytë këtë edicion e ka mposhtur skuadrën

pejane. Rahoveci tani është shkëputur në tabelë me 22 pikë. Ka vetëm fitore. Besa mbetet e dyta me 16 pikë, por ka një ndeshje më pak të luajtur. Në pjesën e parë Besa Famgas krijoi epërsi deri në katër gola, 9:5. Por më pas “vreshtarët” u kthyen dhe deri në fund të pjesës së parë u zhvillua lojë e barabartë. Deri në minutën e 50-të sërish vendasit ishin kryesisht para me një e dy gola. Në minutën e 51-të, Rahoveci kaloi para me dy gola, 24:22. Besa

Famgas barazoi në 24:24 e më pas kaloi në epërsi 25:24. Në minutën e 56-të për epërsinë 26:25 të Rahovecit shënoi pivoti Jeton Bislimi. Besa sërish barazoi në 26:26, ndërsa për 27:26 në të mirë të Rahovecit shënoi Mali Luzha. Curri më pas bëri pritje vendimtare, kurse Bislimi shënoi për 28:26 në minutën e 58-të. Igor Chesliov shënoi golin e 27-të për Besën në minutën e 59-të, ndërsa në fund penalti për 29:27 shënoi Victor Alonso. Alonso e Jon Muqolli

ishin më efikasët te Rahoveci me nga gjashtë gola. Te Besa, Ajdin Smajlbegović i shënoi shtatë gola, ndërsa gjashtë i kishte Arbios Mushkolaj. Ndeshja ishte thuajse e barabartë gjatë tërë kohës dhe të dy skuadrat kanë dëshmuar se do të zhvillojnë garë të fortë deri në fund të edicionit. Të dielën u luajt edhe ndeshja Vushtrria-Kastrioti. Fitore shënoi skuadra ferizajase me rezultat 38:31. Te hendbollistet u luajt ndeshja Vëllaznimi-Prishtina. Skuadra prishtinase fitoi 41:27.


## Derbi mes Juventusit dhe Interit mbyllet pa fitues

**Torino, 26 shtator** - Juventusit dhe Interit nuk shkojnë më shumë se një barazim 1-1 në derbin e Italisë. Ishte një ndeshje që dhuroi shumë emocione, por vetëm dy gola. Bardhezinjtë e nisën më mirë ndeshjen, duke

qenë më kërkues në minutat e para, ku dhe do të gjenin golin. Në minutën e 27-të, pas një aksioni të bukur, Chiesa pason në zonë, atje ku Vlahović me një të djathtë të saktë e dërgon topin në cepin e portës.

Kundërpërgjigja e Interit nuk vonon as 5 minuta. Lautaro Martinez me një lëvizje të bukur në zonë e dërgon topin në cepin e portës, duke mos i dhënë mundësi reagimi portierit polak të bardhezinjve. Më pas rezultati

nuk do të ndryshonte as në 45 minutat e dyta, ku ndeshja do të bëhej më taktike dhe ku të dyja skuadrat kishin frikë të rrezikonin. Interi mbetet në krye më 32 pikë, dy më shumë se Juventusit që ka 30 pikë.





## Shuhet biznesi "RIVI SHPED", Sh.P.K

## NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se "RIVI SHPED", Sh.P.K, me seli në Prizren ka marrë vendim të shuajë biznesin me NUI: 810199770 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë – Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "RIVI SHPED", d.o.o., od Prizrena donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 810199770 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all clients that "RIVI SHPED", L.L.C, has taken the decision to quit its business with NUI: 810199770, from Prizren, has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook 

[www.facebook.com/gjejpuneshejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshejte)


## RESTAURANT

SWISS  
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

- N.T.P. "Blera M" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810930059.

- Arlind G. Gashi B.I. Frishop Ari shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 812056093.

- Afrim Sahatqija nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Marigona Nue nga Doli, KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Anton Qeta" Dol, KK Gjakovë nga kl. I-X dhe VI-IX.

- Dea Qerkezi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10. 11. 12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Shaqir Jashari B.I shpall të pavlefshme arkën fiskale me numër UNIK: 811116070.

- Nysret Tunuzliu B.I, shpall të pavlefshme arkën fiskale me numër UNIK: 810002832.

- Imer Himaj nga Osek Hyla KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, të sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë Transport Rrugorë.

- Bedri Nezaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klm I, II të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Fisnik Kumnova nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Mjekësisë Gjakovë.

- Ferdane Alidemaj shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fazli Greicevci".

- Ubejd Gashi shpall te pavlefshme diplomën e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës me nr. të diplomës 4157.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



